

NEVILA MEHMETI

Fakulteti i Edukimit, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
nevilamehmeti@yahoo.com

**LËVIZJA KOMBËTARE NË MANASTIR:
KLUBI I MANASTIRIT****Abstrakt:**

Ky punim fokusohet në kontributin e madh që dhanë për lëvizjen kombëtare patriotët shqiptarë që jetonin në qytetin e Manastirit, kontribut që kulmoi me krijimin e Klubit të Manastirit apo Klubi “Bashkimi” i Manastirit. Qëllimi i këtij punimi është të paraqesë këndvështrimet e ndryshme të shtypit dhe të autorëve shqiptarë e të huaj mbi veprimtarinë e madhe që patriotët shqiptarë, pjesë e Klubit të Manastirit, luajtën jo vetëm në çështjen e arsimit, por edhe në gjithë Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.

Menjëherë pas fitores së Revolucionit Xhonturk, shqiptarët ngritën komitetet e tyre me qëllim organizimin sa më të mirë të lëvizjes së tyre kombëtare. Si një efekt domino, për nga mënyra se si u përhapën klubet shqiptare, Manastiri nuk mund të mbetej jashtë kësaj veprimtarie. Trualli për këtë veprimtari kombëtare të organizuar tanimë ishte krijuar me shumë mundime vite më parë. Që në vitin 1905, në këtë qytet u krijua një bërthamë revolucionare e lëvizjes shqiptare, që kishte deklaruar hapur qëllimet e saj për më shumë të drejta kombëtare.

Fjalë kyçe:

Manastir, lëvizje kombëtare, Klubi i Manastirit, arsim kombëtar, Portë e Lartë, politikë xhonturke, Patrikanë.

Manastiri është një qytet i lashtë i njohur me emra të tillë si “Butellion”, “Tala Manastir” etj.¹ Për shkak të një pozite interesante, Manastiri kishte mundur të krijohej si një qendër banimi, e populluar nga etni të ndryshme. Natyrisht që nga lashtësia e deri në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, ngjarjet politike dhe luftërat kishin bërë që

¹ Ali Vishko, *Manastiri me rrethina në gjysmën e dytë të shek. XX-të* (Shkup: Flaka e Vëllazërimit, 1988), 13.

qyteti të ndryshonte strukturën e popullsisë, por jo të humbiste rëndësinë e vet. Në këtë periudhë Manastiri ishte një qytet kozmopolit në pikëpamje të popullsisë (pak a shumë i ngjashëm me Selanikun ku kishte shqiptarë, bullgarë, serbë, turq, romë etj.), duke u kthyer dalëngadalë në një qendër të rëndësishme ekonomike, politike dhe administrative. Zhvillimi ekonomik dhe financiar i dha mundësinë Manastirit që të gëzonte edhe statusin e qendrës së vilajetit me të njëjtin emër.

“Një hap të madh për zhvillimin e vet Manastiri bëri në shekullin XIX, kur tregtia kishte marrë hov, ndërsa ky qytet ishte bërë qendër e madhe ekonomike për Shqipërinë e Mesme dhe Jugore, Epirin dhe Maqedoninë Perëndimore.”²

Në këtë qytet filluan të lëviznin, të jetonin dhe të kryenin veprimtarinë e tyre shumë prej personaliteteve të shquara të shqiptarëve. Në këtë kohë Manastiri konsiderohej edhe si qytet i konsujve, pasi shumë shtete të rëndësishme, si: Rusia, Austro-Hungaria etj., kishin konsullatat e tyre në këtë qytet. Për shkak të pozitës së tij, qyteti ishte bërë një pol tërheqës, për kategori të tilla si: nëpunës të Perandorisë Osmane, tregtarë, përfaqësues të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, por edhe njerëz që vuajtën dënimet në këtë qytet. Është i njohur fakti se Bajram (Bajo) Topulli, një emër i njohur i nacionalizmit shqiptar, kishte kryer detyrën e nëndrejtorit të gjimnazit turk të këtij qyteti. Një veprimtari mjaft aktive në fushën e arsimit shqiptar në qytet kishte luajtur edhe Gjergj Qiriazit, i cili ishte njëri prej figurave më të njohura të Kongresit të mbajtur në këtë qytet në vitin 1908. Kontribut të rëndësishëm për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare jepnin jo vetëm ata që jetonin në liri, por kishte edhe atdhetarë shqiptarë, të cilët edhe pse të burgosur, nuk hiqnin dorë nga përpjekjet për ta ndihmuar zhvillimin kulturor kombëtar. Studiuesi Ali Vishko, ia atribuon hapjen e shkollës së parë shqipe, Gjergj Qiriazit. “*Shkolla fillore private shqipe në Manastir u hap në vitin 1886 nga ana e patriotit të njohur Gjergj Qiriazit.*”³ Ky pohim përforcohet edhe në një reportazh të gazetës “Koha. net”, botuar më 2017, ku gazetarja Brikenda Rexhepi, që në hyrje shkruan, “o punoj për mëmëdhenë, gjithë jetën sa të roj, do t’i zgjoj edhe ata që flenë, kështu jetën ta mbaroj.

² *Po aty.*

³ *Po aty*, 266.

“Vargjet i ka shkruar një rilindës që 132 vjet më parë hapi në Manastir një shkollë private shqipe për djem e vajza. Është njëri nga intelektualët e shquar të kohës. I takon familjes që njihet simbol i ngritjes kombëtare.”⁴

Nga mënyra e paraqitjes së fakteve dhe kronologjia e ngjarjeve, na bën të mendojmë se përfaqësues i një familjeje që njihet si simbol i ngritjes kombëtare duhet të ketë qenë Gjergj Qiriazhi, i cili në këtë periudhë rezultoi mjaft aktiv në veprimtarinë e tij për arsimin në gjuhën amtare. Duke marrë parasysh rrezikun, Qiriazhi zhvilloi një veprimtari të dendur legale dhe ilegale në Manastir në shërbim të arsimit kombëtar.

“Gjergj Qiriazhi mbante në Librarinë protestante në Shoqërinë biblike edhe një librari të vogël ilegale shqiptare. Me qëllim që të ndihmohet emancipimi kulturor i shqiptarëve si në Manastir ashtu edhe në vende të tjera, Gjergj Qiriazhi me ndihmën e patriotëve të tjerë shqiptarë në atë qytet kishte themeluar edhe shtypshkronjën “Bashkimi i Kombit.”⁵

Duke u nisur nga kjo traditë e krijuar, Manastiri si qytet mori një rëndësi të dorës së parë për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, veçanërisht në fillimet e shek. XX. Ky qytet ishte kryeqendra e vilajetit të Manastirit dhe për pasojë edhe një qendër e një pjese të madhe të përfaqësive të Fuqive të Mëdha. Duke pasur një pozitë të tillë, Manastiri ishte kthyer në një arenë të veprimtarisë kombëtare shqiptare, të kombinacioneve politiko-diplomatike, sikundër u bë edhe mbështetje e lëvizjes së xhonturqve për të ardhur në pushtet.

Nuk ka dyshim se Manastiri, gjithashtu, nuk mund të ishte jashtë vëmendjes së shteteve fqinje për shkak të pozitës që zotëronte edhe në pikëpamje gjeostrategjike. Bullgaria, Greqia dhe Serbia kërkonin të dominonin me ndikimin e tyre në vilajetin e Manastirit. Një nga mjetet më të rëndësishme të ndikimit të shteteve ballkanike në trevat shqiptare, ishin shkollat. Arsimi u pa si një mjet efikas për të realizuar qëllimet dhe politikën e këtyre vendeve. Këto shtete duke pasur si qëllim të forconin pozitën e tyre në qytet, hapën shkollat në gjuhën serbe, bullgare dhe greke me synimin që të tërhiqnin sa më shumë nxënës në to. Për të arritur qëllimet e tyre, krahas një politike agresive arsimore, shtetet ballkanike nuk ngurruan të hedhin në veprim banda të armatosura, që udhëhiqeshin

⁴ http://sakte.net/manastiri_qyteti_i_alfabetit_pa_shkolla_shqipe.

⁵ Vishko, *Manastiri me rrethina*, 266.

nga komitetet e fshehta të krijuara brenda vilajetit të Manastirit. Në një rivalitet të jashtëzakonshëm ishin edhe drejtuesit e kishave serbe, bullgare dhe greke, për të siguruar edhe ata përkrahësit e tyre, në përputhje me politikën e shteteve respektive. Secili nga shtetet fqinje ballkanike, përmes veprimtarisë së kombinuar synonte aneksimin e këtyre territoreve. Pashiqi u lëshoi një urdhër përfaqësuesve diplomatikë të Serbisë:

“Të mbrojmë bashkatdhetarët tanë nga pasojat e dëmshme të monopolit të Patrikanës, të cilat janë vënë në shërbim të helenizmit, në dëm të përkrahësve jo-grekë të kishës patrikane dhe i kundërvihen veprimtarisë së agjentëve të Ekzarkatit, komitetet e së cilës po na dalin me armë në krahinat me interes madhor për ne: Poreç, Kërçovë, Drimkol, Qypri.”⁶

Veprimtaria e bandave të armatosura u bë gjithnjë e më aktive në vilajetin e Manastirit, kur u pa se shkollat nuk arritën të siguronin mbështetjen e menduar më parë. Madje, mund të pohojmë se një tjetër arsye ishte edhe mungesa e kontrollit dhe e stabilitetit të shtetit osman. Të gjitha mjetet e përdorura kishin të vetmin qëllim: të mos lejonin rritjen e frymës kombëtare shqiptare në Manastir, e cila shihej si një pengesë serioze, për çdo plan të shteteve fqinje jo vetëm për këtë qytet, por për të gjithë vilajetin.

Shqiptarët që ndiqnin me kujdes zhvillimet e ngjarjeve, nuk mund të qëndronin duarkryq. Prandaj në Manastir nisi një veprimtari e gjerë në shërbim të gjuhës dhe identitetit kombëtar, me përkthimin e librave të shenjtë në gjuhën shqipe dhe me shpërndarjen e tyre në trevat shqiptare. Si fillim, një arritje e rëndësishme ishte marrja në dorë nga ana e patriotëve shqiptarë e “*Shoqërisë Biblike për Jashtë me seli në Korfuz*”.⁷ Kjo shoqëri botonte një sërë librash të destinuar për institucionet fetare. Deri në atë periudhë këta libra botoheshin në gjuhën greke të vjetër dhe të re. Një pjesë e mirë e tyre binin në duart e besimtarëve ortodoksë shqiptarë. Pra, ishte një mundësi mjaft e mirë për të filluar mësimin e librave të shenjtë përmes gjuhës amtare. Kuptohet se kjo ishte një punë jo fort e lehtë, që kërkonte guxim por edhe përkushtim atdhetar.

⁶ Adanir Fikret, *Die Makedonische Frage: Ihre Entstehung und Entwicklung bis 1908* (Wiesbaden: Franz Steiner Verlag, 1979), 84; Misha Glenny, *Historia e Ballkanit 1804-1999* (Tiranë: Toena, 2007), 206.

⁷ Joseph Swire, *Shqipëria - Ngritja e një mbretërie* (Tiranë: Dituria, 2005), 68.

“Drejtori i magazinës së Biblës në Manastir ishte një shqiptar me një nivel të lartë qoftë për nga kultura, qoftë për nga energjia. Duke e kuptuar faktin që me anë të këtyre botimeve mund të bëhej një propagandë e jashtëzakonshme kombëtare, ai nuk kurseu përpjekjet, duke përzgjedhur dhe stërvitur me kujdes shpërndarësit shqiptarë, detyra e të cilëve ishin të mësonin se në cilin distrikt zyrtarët ishin të rrezikshëm, ku ishin simpatizues dhe ku ishin nacionalistë që kërkonin vetë të rrezikonin.”⁸

Kjo tregon për një strategji të mirëmenduar, në mënyrë që lëvizja të mos goditej që në fillimet e saj si dhe të garantonte një lloj suksesi. Nuk duhet harruar fakti se përmes kësaj shoqërie ishte më pak i mundur edhe njëurvejim i imtë nga zyrtarët osmanë, por, nga ana tjetër, kjo kishte një rrezik të madh në rast se kisha greke zbulonte këtë veprimtari. Lëvizja mund të vihej ndërmjet dy zjarreve: zemërimit të kishës greke dhe raprezaljes së policisë osmane. Për disa vjet rresht rezultatet ishin shumë të mira. Pati një rritje të frymës kombëtare që kishte lidhje edhe me zhvillimet politike të Lidhjes së Prizrenit dhe periudhës që pasoi. Por në fundin e shek. XIX, duket se Patrikana ra në gjurmët e kësaj veprimtarie.

“Porta dhe patrikana greke u alarmuan nga përparimi që kishte bërë arsimit popullor, sidomos në dritën e shpejtësisë me të cilën ishin rrëzuar muret fetare që ata ishin përpjekur të ngrinin. Prandaj, më 1886, u rivendos ndalimi për botimet në gjuhën shqipe dhe shkrimin e saj. Patriarkana kërcënoi me shkikshërim këdo që shpallej fajtor për leximin dhe shkrimin e gjuhës shqipe. Për njëzet e dy vjet ky kërcënim përbëri një pengesë serioze për përparimin e arsimit kombëtar.”⁹

Gjithsesi, këto masa ngadalësuan ritmin e përhapjes së arsimit shqip, por nuk e eliminuan tërësisht këtë lëvizje. Në fillim të shek. XX, ndërmjet viteve 1908-1910, si pasojë e kushteve të reja politike të krijuara pati një rigjallërim të veprimtarisë për gjuhën dhe kulturën kombëtare. Xhonturqit, kundërshtarë të regjimit osman në fuqi, e panë Manastirin si një terren mjaft të favorshëm dhe me mundësi të mëdha për kauzën e tyre. Duke u organizuar me shpejtësi, Turqit e Rinj legalizuan lëvizjen e tyre politike me ngritjen e Komitetit “Cemiyet Ittihad ve Terakki” (“Bashkim dhe Përparim”). Shqiptarët që e shihnin veten më pranë kësaj lëvizjeje të re politike, fillimisht u rreshtuan në krah të saj.

⁸ *Po aty*, 69

⁹ *Po aty*.

“Lëvizja revolucionare e Komitetit “Bashkim dhe Përparim” që ishte formuar në Manastir, kundër administratës hamitiane, e cila nxitej nga osmanlinjtë e rinj (xhonturqit), nga shkaku i pakujdesisë së oficerëve të huaj po rritej pa masë. Anëtarët e Komitetit në Shqipëri po shtoheshin dita-ditës.”¹⁰

Rreshtimi i shqiptarëve në krah të këtij Komiteti ishte një zgjidhje e momentit, për t’i hapur më pas rrugën një lëvizjeje thjesht shqiptare në interes të tyre. Për sa kohë qëllimi i shqiptarëve dhe xhonturqve ishte në të njëjtën valë, ata bashkëpunuan për t’i dhënë më shumë liri Perandorisë Osmane.

Me këtë rast shqiptarët shfrytëzuan mundësitë e krijuara, që të fitonin edhe më shumë liri për veten. Menjëherë pas fitores së Revolucionit Xhonturk, shqiptarët ngritën komitetet e tyre me qëllim organizimin sa më të mirë të lëvizjes së tyre kombëtare. Si një efekt domino, për nga mënyra se si u përhapën klubet shqiptare, Manastiri nuk mund të mbetej jashtë kësaj veprimtarie. Trualli për këtë veprimtari kombëtare të organizuar ishte krijuar me shumë mundime vite më parë. Që në vitin 1905, në këtë qytet u krijua një bërthamë revolucionare e lëvizjes shqiptare, që kishte deklaruar hapur qëllimet e saj për më shumë të drejta kombëtare. Ky organizim me ndikim brenda dhe jashtë qytetit, u kthye në një “Komitet për Lirinë e Shqipërisë”. Këto komitete, të përhapura në disa krahina të vendit, ishin pararendëse të klubeve që u hapën më 1908. Pikërisht fillesa e kësaj lëvizjeje të strukturuar ishte në Manastir, duke i dhënë një tjetër ton Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

“Në krahinat shqiptare, fronti i brendshëm dëshmonte për një ndryshim rrënjësor të mendimit si dhe të veprimit. Në nëntor të vitit 1905, një numër shqiptarësh në qytetin e Manastirit formuan Komitetin për Lirinë e Shqipërisë. Themeluesit e tij ishin kolonel Halit Beu, kryefarmacit në Armatën e tretë, Feim Bej Zavalani, pronar tokash nga Kolonja, Bajo Topulli, ish-drejtor i shkollës së mesme në qytet, Jorgji Qiriazhi, një i krishterë nga Korça që ishte përkthyes në konsullatën austriake në Manastir dhe doktor Sefedini, një veteriner vendas.”¹¹

¹⁰ Syrja Vlora, *Kujtime. Nga fundi i sundimit osman në Luftën e Vlorës*, përkthyer nga Ali Asllani, përgatitja për botim dhe redaktimi M. Verli, L. Dushku (Tiranë: Iceberg, 2013), 33-34.

¹¹ George Gawrych, *Gjysmëhëna dhe Shqiponja* (Tiranë: Bota Shqiptare, 2007), 224. Këtu mund të bëjmë një saktësim: Jorgji Qiriazhi është Gjergj Qiriazhi, ndërsa doktor

Rrënjët dhe fillesat e lëvizjes kombëtare në Manastir dhe protagonistët e saj, duhet t'i kërkojmë më herët. Fuqia e Komitetit për Lirinë e Shqipërisë dhe më pas e Klubit të Manastirit, qëndronte në faktin se rrënjët e saj duhet t'i kërkojmë që në fund të shek. XIX, e në vazhdim.

“Për arsye familjare u vendosëm në Manastir në vitin 1896. Këtu gjeta të formuar një organizatë të përbërë prej ushtarit trim Halid Bej Bërzeshta i njohur me emrin “Bej Baba”. Në fillim punonim në fshehtësi të madhe duke sjellë gazeta së jashtmi dhe duke përfutur në çdo rast për të zgjeruar qarkun e veprimit tonë.”¹²

Ngjarjet e vitit 1908, sollën ndryshimin e situatës politike dhe bashkë me të u përshtat edhe qëndrimi i shqiptarëve, që sillte si domosdoshmëri edhe një tjetër mënyrë organizimi. Klubi ishte një mënyrë e mirë për të punuar qetësisht, të hapur, por njëkohësisht pa hequr dorë nga kërkesat me karakter politik. Shumë shpejt Klubi i Manastirit do të bëhej shembull për mënyrën e veprimit dhe të organizimit të tij. Ky klub u njoh si një organizëm me ndikim mbarëkombëtar dhe që luajti një rol parësor në organizimin e të gjithë lëvizjes arsimore, madje edhe me një vizion shumë modern për kohën, në lidhje me ndikimin që do të kishte arsimit në zhvillimin e vendit. Ky rol shprehet më qartë në shtypin e kohës, i cili në mënyrë kronologjike dhe me nota entuziaste përshkruante krijimin e klubeve patriotike.

“Posa që u dha ndë Shqipëri liria e gjuhësë sonë me anë të Konstitucionit, këtu në Manastir u themelos një kllub nga atdhetarë

Sefedini, me shumë mundësi është Sejfi Vllamasi. Në kujtimet e tij, mes të tjerash, Vllamasi shkruan: “Në korrik të vitit 1905, u emërova veteriner i qytetit të Manastirit. Atje rashë menjëherë në kontakt me Komitetin shqiptar të Manastirit. Në atë kohë Komiteti Qendror përbëhej prej: Kolonel farmacist Halit Bërzeshta (Bej Babaj), Fehim Bej Zavalani, Jorgji Qiriazi, Bajo Topulli, përkatësisht me moshë, 65, 50, 35, 33 dhe unë [S. Vllamasi – N. M.] 22 vjeç, mora pjesë si anëtar i Qendrës”. (Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri* (Tiranë: Marin Barleti, 1995), 26). Duhet theksuar se, për këtë veprimtari Vllamasi u arrestua në vitin 1906 dhe u internua. Ai u lirua vetëm pas tre vjetësh, kur xhonturqit erdhën në fuqi.

¹² Feim Zavalani, “Komiteti i Manastirit dhe ngjarje të tjera”, në *Përpyjekja shqiptare*, nr. 32 (Tiranë: prill 1937), 23. Kujtimet e ish-kryetarit të Klubit të Manastirit janë botuar të ndara në 5 çështje, ku ai flet veçmas për: “Organizatën e Manastirit 1896-1905”, “Marrëdhëniet e mia (Fehim Bej Zavalanit) me austriakët, Bajo Topulli, Hysein Hilmi Pasha etj.”, “Vrasja e Papa Kristo Negovanit” dhe pjesa e fundit mbyllet me: “Lëvizja greko-bullgare në Maqedoni”.

të çquar me qëllim që t'i ndihmonjë gjuhësë shqip, mësonjëtorevet edhe për të përhapurit e mjeshtërivet ndë Shqipëri.”¹³

Gazeta “Lirija” e datës 27 gusht 1908 njoftonte për formimin e Klubit të Manastirit, ndonëse në të vërtetë, ai është formuar më herët se 27 gushti.

“Më 31 korrik 1908 u themelua klubi “Bashkimi i Manastirit” me kryetar Fehim Zavalanin që sapo ishte liruar nga internimi, nënkryetar Gjergj Qiriazin dhe sekretar Naum Naçin.”¹⁴

Edhe vetë gazeta “Lirija” linte të nënkuptuar se klubi ishte formuar në këtë datë.

“Kllubi përpara dy javësh zu të vihet ndë radhë. Pleqësia u zgjoth nga të gjithë shokët që u mblodhnë më 14 gusht ndë shtëpi të Fehim Be Zavalanit.”¹⁵

Përtej saktësisimit të datës së formimit të Klubit të Manastirit, themelimi i tij, krijoi një bazë të fuqishme të lëvizjes kombëtare në një nga qytetet më të rëndësishme të trevave shqiptare. Ishte kjo arsyeja, që ky klub mori një mbështetje të fortë edhe nga shqiptarët, jashtë atdheut, të cilët synonin të inkurajonin punën e këtij klubi të sapoformuar në Manastir. Në një letër dërguar klubit prej shqiptarëve të Rumanisë, mes të tjerash, shkruhej:

“Zemra jonë ndjen një gas të madhë duke parë qëllimet të nalta i këtij kllubi prej të cilit do të hapet rrug e mbrothësisë për shqiptarët. Shkaktare e kësaj punë të shënjtëruar është klubi “Bashkimi” të cilin edhe kombi shpëtonjës munt’ta quajmë. Dhëntë Perëndija, qëllimet t’uaja të shënjtëruara të mbushen një më një për nder dhe lavdi të gjithë shqiptarëve”.¹⁶

¹³ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 102, V. (pa vit), Dosja (më tej: D.) 97, fl. 8; “Thirrja e sekretaris së klubit “Bashkimi”, *Lirija*, nr. 9, Selanik, 8 shtator 1908. Në këtë shkrim vërehet se “Klubi i Manastirit” u shkrojt me vendim e urdhërim të Pleqësisë ndë Manastir 27 gusht 1908”.

¹⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, Rilindja Kombëtare (vitet 30 të shek. XIX - 1912), Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002), 381.

¹⁵ Anonim, “Thirrja e sekretaris së Klubit Bashkimi”, *Lirija*, nr. 9, Selanik, 8 shtator 1908.

¹⁶ *AQSH*, F. 102, V. (pa vit), D. 97, fl. 7-7/1. Letër e Ilia V. Bobit nga Lunxhëria dhe Naqe G. Çonit, drejtuar kryetarit të Klubit “Bashkimi”, në Manastir, Varnë, 30 Vjeshtë e Tretë 1908.

Personalitetet e shquara që u vunë në drejtim të Klubit të Manastirit, e shndërruan atë në klubin më të fuqishëm në trevat shqiptare. Gjergj Qiriazi, Fehim Bej Zavalani, Shahin Kolonja, Nuçi Naçi e mjaft patriotë të tjerë të njohur, ishin intelektualë, përfaqësues të shtresës së mesme, administratorë, ushtarakë dhe mësimdhënës të njohur. Ndonëse Komiteti i Manastirit i ngritur në vitin 1905, mori një goditje të rëndë nga internimet e një grupi patriotësh shqiptarë (përfshi këtu edhe Fehim Bej Zavalanin dhe Halit Bej Bërzeshtën që ishin në një moshë pak a shumë të thyer), merita e këtyre patriotëve është rigrupimi i tyre dhe fillimi i një pune me po aq zell si tre vjet më parë. Me këtë përbërje shumë shpejt klubi u bë një pikë referimi për shqiptarët. Duket fare qartë se përvoja politike e tri viteve të shkuara do të vlente shumë për këta patriotë.

Një tjetër avantazh, pa dyshim ishte edhe fakti që shumica e krerëve të klubit, kishin një njohje më shumë se dhjetëvjeçare me njëri-tjetrin. Ndonëse ishte një bërthamë e vogël njerëzish, ata u përpoqën të kapërcejnë kufijtë lokalë dhe ta shndërrojnë atë në një lëvizje të gjerë brenda së cilës mund të trajtoheshin problemet më të mëdha të shqiptarëve në rrafshin kombëtar, arsimor dhe atë ndërkombëtar.

“Po thuaj në çdo dy ditë kisha bisedime dhe shkëmbime me Z. August Kral*. Qeveria austriake duke pasur si qëllim politik të ndihmojë me çdo mënyrë lëvizjen shqiptare na propozoi të merremi vesh me kryetarin e krahinës Gryka e Madhe të Dibrës, për çeljen e tre-katër shkollave fillore shqipe, për të cilat do të na paguante të gjitha shpenzimet.”¹⁷

Në krahasim me Klubin e Selanikut, të Stambollit, apo të Shkupit, që në njëfarë mase ranë nën ndikimin xhonturk, Klubi i Manastirit kishte një qëndrim të qartë pro çështjes shqiptare. Në shtypin e asaj kohe shkruhej:

“Një gjë vetëm kuzojmë [*guxojmë* – N. M.] t’i këshillojmë fillonjësit me anëtarët e klubeve, të mos zgjedhin kryetarë nënëpunës të qeverisë, jo për tjetër shkak, po që të ketë një fytyrë

* *August Kral* – Konsull i Austro-Hungarisë në Manastir deri në vitin 1904, dhe më pas konsull në Selanik. Dashamirës i çështjes shqiptare. Ishte gjithashtu edhe përfaqësues i Austro-Hungarisë në periudhën e Princ Vidit, i atashuar në Durrës. Ai mbahet mend për një fjalim që mbajti përpara rebelëve në Shijak, duke i ftuar këta të fundit të ulnin armët dhe të respektonin princin e tyre.

¹⁷ Tajar Zavalani, “Komiteti i Manastirit”, *Përpyekja shqiptare* (Tiranë: 1937), 23.

të veçantë dhe të mos jetë drejt për drejt nën influencën e qeverisë”.¹⁸

Themeluesit e Klubit të Manastirit e patën merak të parë këtë vërejtje me shumë vend. Kryetari dhe anëtarët e grupit themelues, nuk kishin asnjë post qeveritar. Emri i klubit “Bashkimi” kishte një kuptim më të gjerë sesa një veprimtari e thjeshtë arsimore. Shqiptarëve u nevojitej bashkimi, për të arritur në synimin e tyre drejt përparimit dhe zhvillimit. Madje, edhe gazeta që u botua si organ i klubit mori emrin “Bashkim”i Kombit”.

“Këtu themelohet një shoqëri të fortë, të së cilës anëtarë janë njerës të dëgjuar e të çquar, si nga muslimanët dhe të krishterët. Këtu do të kemi një shtypshkronjë të madhe e do të shtypim një gazetë të mbaruar me emërin “Bashkim.”¹⁹

Botimi i gazetave nga pothuajse të gjitha klubet patriotike që u ngritën, ishte i një rëndësie të veçantë. Deri në atë kohë shtypi shqiptar ishte përfaqësuar më së shumti nga shqiptarët që jetonin jashtë vendit, në SHBA, Rumani, Bullgari, Egjipt etj. Për herë të parë kemi një shtyp shqiptar të botuar në territoret shqiptare, që i drejtohej më shpejt dhe në mënyrë më të drejtpërdrejtë lexuesit vendës.

“Në vitin 1909-të me anë të një kërkesë bërë Prefekturës së Manastirit nga ana e Klubit Shqiptar, ishte kërkuar që të përjashtoheshin nga taksat doganore pajisjet që do të sillnin nga jashtë për shtypshkronjën që mendonin të hapnin. Mirëpo, kjo kërkesë nuk ishte pranuar për arsye se shtypshkronja ishte konsideruar si një mjet tregtie.”²⁰

Ky shtyp u zhvillua në kushte shumë të vështira. Botimi, shtypja dhe shpërndarja e gazetave në gjuhën shqipe, të cilat në shumicën e tyre ishin organe të klubeve, mundësoheshin nga patriotët shqiptarë. Për sigurimin e të hollave, por edhe për një cilësi të lartë të botimeve, u angazhuan shkrimtarë, redaktorë dhe botues, që ishin ndër emrat më të njohur të elitës së shkolluar shqiptare, si: Lef Nosi, Mit’hat Frashëri, Fehim Zavalani, Jashar Erebara, Mihal Grameno, Mati Logoreci, e shumë të tjerë.

¹⁸ “Klubet e Shqipëtarëve”, *Kombi*, nr. 102, Boston, 18 shtator 1908, 7-8.

¹⁹ “Letër e klubit “Bashkimi” të Manastirit, 11 gusht 1908”, *Kombi*, nr. 105, Boston, 16 tetor 1908, 4.

²⁰ Edwin Jacques, *Shqiptarët. Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme* (Tiranë: Kartë e Pendë, 1995), 337.

“Shtypshkronja e Manastirit shpejt u bë e njohur anembanë vendit si shpërndarëse e librave dhe gazetave shqipe. Ata punonin me një makinë të re elektrike, që vihej në lëvizje me dorë, për të shtypur gazetën e përjavshme “Bashkim’i i Kombit”, abetaret shqipe dhe tekstet shkollore.”²¹ Kjo ndërmarrje jo e lehtë në atë kohë kishte përkrahjen e “sponsorëve myslimanë që ishin simpatizantë të programeve kombëtare të Shoqërisë Biblike dhe bashkëpunuan në botimin e Shkrimeve të Shenjta të krishtera në gjuhën shqipe.”²²

Ndonëse shtypi i asaj kohe, kishte pak lexues (për shkak se vetëm një pjesë e vogël e shqiptarëve dinin shkrim dhe lexim), kjo nuk i dekurajoi patriotët shqiptarë. Në shumë shkrime të gazetave e revistave, gjen që nga artikujt propagandistikë e deri tek ato të analizës për gjuhën, politikën, arsimin, zejtarinë, zhvillimin ekonomik e deri te mundësitë e hapjes së një universiteti shqiptar. Shtypi i asaj kohe e në veçanti ai që ishte zëdhënës i klubeve shqiptare, reflektonte një punë të kualifikuar intelektuale. Natyrisht që në kushtet në të cilat u zhvillua, ishte një shtyp sa propagandistik aq edhe polemik, sa këshillues për shqiptarët aq edhe promovues për punët e mira që bëheshin. Në të, gjeje artikuj kritikë për bashkëqytetarët që braktisnin idealin kombëtar, por edhe lavdërues për këdo që hapte një shkollë të vogël në një fshat, apo që dhuronte libra me bujari. Kultivimi i kësaj kulture në shtyp, ka qenë një meritë tjetër e klubeve patriotike. Për të realizuar një koordinim më të mirë të punëve në të gjitha trevat shqiptare, Klubi i Manastirit mori iniciativën “*për të dërguar në qytetet e tjera emisarët e vet për të propaganduar idetë kombëtare të shqiptarëve, siç ishin bashkimi i vilajeteve shqiptare dhe ruajtja e tërësisë së saj*”.²³ Madje, po të shohësh me vëmendje shkrimet e asaj kohe, shumica e klubeve u quajtën “Bashkimi”.

Anëtarët e Klubit të Manastirit e shtrinë veprimtarinë e tyre edhe jashtë kufijve të territoreve shqiptare. Klubi i Manastirit gjatë gjithë ekzistencës së tij, u karakterizua nga një veprimtari e shumanshme, në ndihmë të çështjes kombëtare shqiptare. Ky klub, përpos detyrave mjaft të rëndësishme që kishte për të zgjidhur, nuk la pas dore edhe përhapjen e ideve kombëtare në territoret ku anëtarët e klubit kishin ndikim. Kjo veprimtari tregon, për vizionin e qartë që kishin drejtuesit e këtij klubi. Madje, Gjergj Qiriazi la postin e rehatshëm të përkthyesit në konsullatën

²¹ *Po aty*, 345.

²² *Po aty*.

²³ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, 381.

e Austro-Hungarisë, për të punuar për çështjen kombëtare. Klubi i Manastirit me thirrjet e tij për bashkimin e vilajeteve dhe ruajtjen e tërësisë tokësore, tejkallonte kufizimet që klubet shqiptare i kishin vënë vetes. Ky qëndrim shpjegohet nga kryetari i këtij klubi, Fehim Zavalani.

“Ne e kuptonim se asnjë rezultat i dobishëm dhe i dëshirueshëm nuk mund të arrihej me anë të propagandës së shkruar dhe asaj gojore dhe nisëm ta përgatisnim publikun për të pranuar idenë e një kryengritjeje të armatosur.”²⁴

Mobilizimi i popullsisë, për një përballje ushtarake me Portën e Lartë, ishte një strategji që do të vihej në funksion në një periudhë të mëvonshme. Gjatë vitit 1908, puna e klubit u përqendrua te mësimi shqip, hapjen e shkollave dhe në përhapjen e arsimit në gjuhën amtare. Për mësimin e shqipes, duheshin shkollat të cilat u ngritën falë bujarisë dhe mbështetjes së mbarë shtresave të popullsisë. Po kaq me rëndësi ishte sigurimi i librave për mësimin dhe shpërndarja e tyre, në vendet ku ishin hapur shkollat. Gawrych-i na tregon gëzimin e madh të një patrioti, për shpërndarjen e librave në shqip “*Nukë na besohet, na duket si një ëndër, dhe më tepër çuditemi, se sot neve mund të ndajmë vivlla [libra – N. M.] dhe tëjshkrime në gjuhënë tonë.*”²⁵ Korça dhe Manastiri u bënë dy qendrat më të rëndësishme, ku grumbulloheshin librat shqip të ardhur nga jashtë vendit dhe që më pas shpërndaheshin në krahina të ndryshme të Shqipërisë. Diplomatët austro-hungarezë në raportet e tyre, vënë në dukje se:

“në këto vise [të Shqipërisë] sillen me shumicë gazeta dhe librat shqipe që botohen në Bukuresht dhe pastaj nga Manastiri e Korça dërgoheshin në pjesët e tjera të Shqipërisë [Shqipëria e Poshtme], Tepelenë, Gjirokastrë, Berat, Elbasan, dhe në Dibër”.²⁶

Në vijim të punës për krijimin e një organizate të mirëfilltë kulturore (por pa harruar asnjëherë sfondin politik), Klubi i Manastirit miratoi statutin “*Kanonizma e ligj'e klubit të shqiptarëve në Manastir*”.²⁷ Më shumë se një dokument për të ligjëruar veprimtarinë e klubit në sy të xhonturqve, statuti i tij (si edhe statutet e klubeve të tjera

²⁴ Gawrych, *Gjysmëhëna dhe Shqiponja*, 225.

²⁵ Hysni Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit* (Tiranë: Albpaper, 2004), 67.

²⁶ Hysni Myzyri, “Zhvillimi i arsimit në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX (1882-1908)”, në *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, vëll. I (Tiranë: Nënë Tereza, 2003), 159.

²⁷ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, 381.

në Shqipëri), ishte në të vërtetë, një program pune për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Këto rregullore patën një karakter të përkohshëm, pasi vetë ngjarjet diktuan të tjera strategji dhe ide për zhvillimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Megjithatë, duhet theksuar se, pothuajse të gjitha klubet me ndonjë përjashtim të vogël, kishin një program thuajse të njehsuar: hapja e shkollave shqip, përhapja e librave në gjuhën amtare, përgatitja e librave dhe shpërndarja e tyre, gjetja e mësimitdhënësve, bashkimi i shqiptarëve rreth interesave kombëtarë etj.

“Klub’i Manastirit pas një lajme të “Lirisë” paska gjer më sot 85 anëtarë. Përsa i përket statutit të kësaj shoqërije [*Klubit të Manastirit – N. M.*], ky përbëhet prej 42 paragrafëve dhe kanonismat paskan për qëllim të sjellin dashurinë nëpërmjet shqiptarëve të Manastirit dhe të zgjuajë ndjenjat kombëtare të tyre.”²⁸

Për veprimtarinë e Klubit të Manastirit, bien në sy të dhënat që vijnë nga Bilgin Çelik, autori turk i librit “Përparimtarët dhe Shqiptarët”. Ai trajton një anë të panjohur të arsyeve se përse klubi i formuar në Manastir ishte i përbërë nga shqiptarë jugorë dhe kishte njëfarë distancimi të shqiptarëve gegë (veriorë).

“Dukej interesante kritika që Klubi shqiptar i krijuar nga Shqiptarët Toskë (Shqiptarët e Jugut) në Manastir, kritikonte Gegët (Shqiptarët e Veriut). Ndryshimi i pikëpamjeve mes tyre kishte nisur të dukej që në fillim. Në një lajm të botuar në një gazetë shkruhej se ashtu si Toskët edhe Gegët mbështetën krijimin e një klubi që do të bashkonte shqiptarët dhe për këtë në Manastir, dashamirësit e shoqërisë bënë një mbledhje.”²⁹

Më poshtë Bilgin Çelik shpjegon qartësisht se cila ishte pika që ishte bërë pengesë për realizimin e idesë për një klub të përbashkët.

“Por që në këtë mbledhje të parë ata [*gegët dhe toskët – N.M.*] nuk kishin arritur në një përfundim. Ata kishin vendosur të realizonin një takim të dytë, mirëpo përpara takimit të dytë Shqiptarët Toskë përgatitën një urdhëresë dhe në nenin e parë të programit shkruhej se klubi do të zhvillonte veprimtarinë e tij jo në “elementin fetar”, por sipas nevojave themelore. Duke parë se nuk do të mund të

²⁸ *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHS.A.PA.A.*) në *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj. 18-4-416.

²⁹ Çelik Bilgin, *Ittihatçılar ve arnavutlar* (Stamboll: Buke Kitapları, 2004), 246.

krijohej një bashkim i tillë Shqiptarët Gegë morën vendim për të krijuar shoqëritë e tyre.”³⁰

Ky është një konstatim nga ana e autorit turk, për ta thjeshtëzuar çështjen në një debat fetar, ndonëse është e vështirë që të shpjegohet thjesht si një mungesë dakordësie. Megjithatë, Bilgin Çelik këmbëngul, se kjo ishte e vetmja arsye, pasi që në fillim të shpjegimit që ai bën për krijimin e klubeve, ndan klubet me një qëndrim dhe drejtim patriotik shqiptar dhe ato që u manipuluan ose treguan se ishin mbështetëse të osmanëve. Ngjarjet e mëvonshme, në gjykimin tonë nuk e mbështesin pretendimin e Bilginit.

“Pas vitit 1908 në mjedisin e lirisë që solli konstitucionalizmi, intelektualët shqiptarë krijuan shumë shoqëri, klube duke u përfshirë në një veprimtari intensive kulturore. Një pjesë e shqiptarëve me vullnetin për të nxjerrë në plan të parë identitetin kombëtar, ndonëse theksuan në letrat e tyre se nuk do të merreshin me politikë, krijuan këto shoqëri duke pasur qëllime politike.”³¹

Mirëpo në periudhën në të cilën u krijuan, përveç objektivit parësor të përhapjes dhe kultivimit të gjuhës shqipe, Klubi i Manastirit, në prag të zgjedhjeve për në Parlamentin e ri, e gjeti veten mes dy detyrave: asaj për përhapjen e arsimit shqip, si dhe detyrës për përkrahjen e një fushate për zgjedhjen e deputetëve shqiptarë që do të përfaqësonin interesat kombëtarë. Në lidhje me përhapjen e arsimit shqip të bie në sy fakti, se ky klub riaktivizoi idenë e dikurshme të përkthimit dhe të shpërndarjes së librave fetarë në gjuhën shqipe. Misionin për këtë e mori Gjergj Qiriazi i ndihmuar nga i vëllai, Gjerasim.

“Qiriazi [*Gjergji – N. M.*] botoi në shtypshkronjën e Manastirit një përmbledhje të himneve dhe këngëve të shenja, 61 prej të cilave të përkthyer dhe të shkruara prej atij vetë, kurse 45 nga i vëllai Gjerasimi.”³²

Në rrafshin politik, përfaqësimi në Parlamentin Osman u siguronte shqiptarëve një mundësi më tepër në kërkim të të drejtave të tyre. Është më se e drejtë që të shpresohet se zgjidhja më e mirë e problemeve të shqiptarëve, të arrihet përmes mjeteve politike. Në rast se xhonturqit, do të kishin një vizion më të përparuar për t’iu dhënë shqiptarëve të drejtat

³⁰ *Po aty*, 246.

³¹ *Po aty*, 242.

³² Jacques, *Shqiptarët*, 346.

kombëtare, atëherë edhe këta të fundit do të rishikonin të gjithë veprimtarinë e tyre. Nuk duhet anashkaluar fakti, që patriotët shqiptarë kërkuan të dërgonin sa më shumë përfaqësues nga vilajeti i Manastirit, në Parlamentin e ardhshëm. Zgjedhja e deputetëve me profil kombëtar, për në Parlamentin Osman, nuk mund të bëhej pa përkrahjen e klubeve, të cilat, kishin fituar një ndikim të madh që në ditët e para të veprimit të tyre. Prandaj ishte e natyrshme që një pjesë e deputetëve të dilte, pikërisht nga radhët e anëtarëve të këtyre klubeve. Shqiptarët nuk dëshironin t’iu rrëshqiste nga dora ky rast, pasi ishte mundësia më e mirë për të fituar të drejtat e tyre kombëtare përmes përfaqësimit në Parlament.

“Gjithë klubet duhet ta dinë këtë që, siç janë sot organizuar, nuku kanë ndonjë fuqi dhe për këtë duhet të mendohen e të çalltisin që të njihen nga Mbledhja e Kombit [*Parlamenti Turk* – N. M.] për vetë gjyqëtarë [*në kuptimin si organ legjitim vetëqeveris* – N. M.]. Depytenjtë shqiptarë duhet të kujedesenë përë këtë fort shumë edhe çalltisin me gjithë fuqin’ e tyre, se, siç thamë pa këtë të drejtë, s’ka asnjë fuqi nonjë klub.”³³

Parë në këtë këndvështrim, duket se patriotët shqiptarë ende shpresonin për një trajtim më legal të çështjes së tyre kombëtare. Elita shqiptare mendonte se deputetët do të ishin zëdhënës të kërkesave kombëtare shqiptare, ku gjuha dhe arsimiti, zinin vendin e parë. Prandaj që në fillim të veprimtarisë së tyre, klubet u panë, si bërthama e qeverisjes së ardhshme në territoret shqiptare. Nëse arrihej nëpërmjet rrugës parlamentare, ky do të ishte hapi i parë i bashkëpunimit real mes shqiptarëve dhe xhonturqve. Kjo do të kursente nga ana tjetër edhe mundësinë e një konflikti të hapur mes të dyja palëve, që në situatën e rëndë që po kalonte Perandoria Osmane, nuk ishte në interes as të shqiptarëve, as të shtetit osman. Por nëse kjo nuk do të arrihej në rrugë parlamentare, sikurse e kishte bërë të njohur, drejtuesi i Klubit të Manastirit, Zavalani, atëherë nuk përjashtohej mundësia e një lëvizjeje e armatosur. Pikërisht për këtë lëvizje ky klub mori masat e tij.

“Pranë tyre [*klubeve* – N. M.] u krijuan komitete të fshehta, të cilat do të merreshin me propagandën kundërosmane dhe me organizimin e luftës për autonominë e vendit. Një komitet i tillë i fshehtë u formua në vjeshtën e vitit 1908 pranë klubit “Bashkimi” të Manastirit. Me nismën e veprimtarit të njohur Themistokli

³³ Mihal Grameno, “Klubet Shqipëtarë”, *Korça*, nr. 4, Korçë, 22 janar 1909.

Gërmenji, Komiteti i Manastirit vendosi lidhje me komitetet e fshehta maqedone dhe bashkëpunoi me to për të siguruar armë.”³⁴

Rruga revolucionare këtë radhë drejtohej ndaj xhonturqve, pra atyre që pak muaj më parë, vetë shqiptarët i kishin ndihmuar për të ardhur në pushtet. Madje, Komiteti i Manastirit e zgjeroi këtë organizim edhe në qytete të tjera.

“Ky klub dërgoi njerëz për themelimin e komiteteve të fshehta në qytetet e vilajeteve të Manastirit e të Kosovës. Në nëntor, komitetet e fshehta vepronin në Korçë, Kolonjë, Kozhanë, Selfixhe etj.”³⁵

Fryma e Komitetit të Manastirit u përhap me një shpejtësi që nuk pritej. Përfaqësitë diplomatike të Vjenës në qytete të ndryshme shqiptare, ndiqnin me shumë kujdes zhvillimin e ngjarjeve të fundit. Duke studiuar me vëmendje situatën, ata vunë menjëherë në dijeni eprorët e tyre në Vjenë. Më 7 dhjetor 1908, konsulli austriak në Manastir njoftonte Vjenën se “komitete të tilla të fshehta qenë ngritur tashmë në çdo qytet e fshat të Shqipërisë”.³⁶

Austro-Hungaria i frikësohej një rebelimi të armatosur të shqiptarëve, i cili mund të shpërthente në mënyrë të pakontrollueshme. Disa herë konsujt austro-hungarezë kishin paralajmëruar apo kishin lënë për të kuptuar se një lëvizje për hapjen e shkollave, mund të kthehej në një kryengritje të armatosur në rast se xhonturqit do të vazhdonin të refuzonin kërkesat me karakter arsimor të shqiptarëve. Diplomatët arrinin në këtë përfundim, duke parë politikën që ndiqte Porta e Lartë ndaj kërkesës më elementare të shqiptarëve për shkollim në gjuhën e tyre amtare. Ndërkaq xhonturqit kishin filluar të bënin hapa pas. Edhe pse ishte lejuar hapja e shkollës së vashave që më 1891, filluan të vënë nën vëzhgim të rreptë mësuesit dhe themeluesit e kësaj shkolle. Një nga aktet më të pashembullta ishte përndjekja që iu bë veprimtares së shquar të arsimit kombëtar shqiptar, Parashqevi Qiriazi, e cila ishte e vetmja femër delegate në Kongresin e Manastirit. Ajo krijoi të parën shoqëri të grave shqiptare “në janar të vitit 1909”.³⁷ Qëllimi i krijimit të shoqërisë, ishte emancipimi i gruas shqiptare, arsimimi i saj dhe një rol më i madh në jetën shoqërore të vendit. Po cili qe shkaku i konfliktit me autoritetet

³⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, 384.

³⁵ *Po aty*.

³⁶ *Po aty*.

³⁷ Jacques, *Shqiptarët*, 346.

xhonturke? Në fillim të shkurtit të vitit 1910, shkolla që njihej me mbiemrin e familjes së saj vuri në skenë dramën e njohur “Vilhelm Tel”, e cila u interpretua në gjuhën shqipe, ngjarje kjo që nuk kaloi pa u vënë re nga administrata osmane.

“Parashqevia u thirr në gjyq, ku e vunë në bankën e të akuzuarve. Dukej qartë që qëllimi i akuzës ishte ta frikësonin dhe ta detyronin më mirë të hiqte dorë sesa të dilte para gjyqit.”³⁸

Qëndrimi i ngurtë dhe madje edhe armiqësor, sidomos ndaj arsimit kombëtar të shqiptarëve nga ana e xhonturqve, paralajmëronte një lëvizje të armatosur. Një shqetësim të tillë paraqiti edhe amerikani Hoxhson, i cili ishte inspektor i Shoqërisë Biblike në Stamboll. Gjatë inspektimit në punishten e Shoqërisë Biblike në Manastir në fillim të vitit 1911, ai thekson se,

“të gjitha shkollat shqipe janë mbyllur pa pikë mëshire, kurse përpjekjet ngulmuese për ndalimin e gjuhës dhe zhdukjen e letërsisë shqipe nuk kanë reshtur kurrë. Gjendja e rëndë politike mund të marrë flakë nga çasti në çast”.³⁹

Anëtarët e Klubit të Manastirit, merrnin në konsideratë edhe qëndrimin që mund të mbanin maqedonasit dhe grekët, në rast të një lëvizjeje të armatosur nga ana e tyre. Për këtë qëllim u përpunua ideja e një aleance të mundshme me maqedonasit, për të fituar të drejtat për të cilat të dy popujt aspironin. Edhe zgjedhja e aleancës me çetat maqedonase prej Komitetit të Manastirit ishte pragmatiste për kohën. Të dyja lëvizjet i bashkonin çështje të përbashkëta. Nga të gjitha territoret nën sundimin e Perandorisë Osmane, vetëm territoret shqiptare dhe ato maqedonase mbetën në një gjendje në vend numëro. Gjithsesi, shqiptarët ndiheshin në një pozitë më të disfavorshme se të tjerët. Studiuesi i njohur, Skëndi vëren se,

“Komisioni Special i ngarkuar për reformat në Maqedoni, i kryesuar nga Hilmi Pasha, përfaqësonte gjithë grupet etnike të Turqisë Evropiane me përjashtim të shqiptarëve”.⁴⁰

Shqiptarët u ndodhën tërësisht jashtë agjendës së Perandorisë Osmane dhe Fuqive të Mëdha, prandaj i vetmi mjet që u mbetej ishte qëndresa e armatosur. Forca e armëve kishte treguar edhe më parë se ishte mundësia

³⁸ *Po aty.*

³⁹ *Po aty.*

⁴⁰ Stavro Skëndi, *Zgjimi kombëtar shqiptar* (Tiranë: Phoenix, 2000), 167.

e vetme për t'u dëgjuar si nga Fuqitë e Mëdha, ashtu edhe nga Porta e Lartë. Kësaj i shtohet fakti që, si territoret shqiptare ashtu edhe ato maqedonase, synoheshin prej Greqisë. Kështu, shqiptarët dhe maqedonasit i bashkonte i njëjti interes, prandaj Klubi i Manastirit, në aleancën mes tyre dhe maqedonasve, kërkonte të ruante krahët, në rast të një konflikti të armatosur me Portën e Lartë.

Kjo strategji e ndjekur nga Klubi i Manastirit, tregon edhe njëherë se, në veprimtarinë e gjerë që zhvilloi ky klub, ishte shembull për klubet e tjera. Ky ishte ndër të paktat klube që përdori të gjitha mjetet për çështjen kombëtare: përhapjen e gjuhës dhe të arsimit shqip, shtypjen dhe botimin e librave, një shtyp aktiv përmes gazetës “Bashkim”i Kombit” (titulli i së cilës u përdor deri në vitet '40 të shek. XX në shtypin shqiptar), si dhe përgatitjet për luftën e armatosur. Natyrisht që mund të thuhet se këtë ia mundësonte si pozita e qytetit, ashtu edhe përbërja e tij. Kjo mund të jetë pjesërisht e vërtetë. Manastiri ishte një qytet që kishte treguar mosbindje ndaj Portës së Lartë, por po kaq e rreptë ishte treguar kjo e fundit ndaj këtij rebelimi (le të kujtojmë internimet e viteve 1905-1906). Prandaj, nuk mund të thuhet se xhonturqit e kishin jashtë vëmendjes veprimtarinë e lëvizjes shqiptare që zhvillohej në Manastir dhe se e toleronin me dashje atë. Mund të jetë i vërtetë fakti që anëtarë të tillë si: Çerçiz Topulli, Themistokli Gërmenji etj., me frymë nacionaliste i dhanë edhe një dorë radikalizmi veprimeve të Klubit të Manastirit.

Bibliografi:

Arkiva:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Fondi 102, D. 97

Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë (AIH)

Fondi: Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien (HHStA.PA.A)

Literaturë historiografike:

Bilgin, Çelik. *Ittihatçılar ve arnavutlar*, Stamboll: Buke Kitapları, 2004.

Dedja, B. & Ceka, N. & Dedej, & S. Myzyri, H. Kashari, Q. Osmani, Sh. Gogaj, I. *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*, vëll. I. Tiranë: Nënë Tereza, 2003.

Gawrych, George. *Gjysmëhëna dhe Shqiponja*. Tiranë: Bota Shqiptare, 2007.

- Glenny, Misha. *Historia e Ballkanit 1804-1999*. Tiranë: Toena, 2007.
- Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, Rilindja Kombëtare (vitet 30 të shek. XIX - 1912), grup autorësh. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë. Tiranë: Toena, 2002.
- Jacques, Edwin. *Shqiptarët: Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*. Tiranë: Kartë e Pendë, 1995.
- Myzyri, Hysni. *Shkolla Normale e Elbasani*. Tiranë: Albpaper, 2004.
- Skëndi, Stavro. *Zgjimi kombëtar shqiptar*. Tiranë: Phoenix, 2000.
- Swire, Joseph. *Shqipëria ngritja e një mbretërie*. Tiranë: Dituria, 2005.
- Vishko, Ali. *Manastiri me rrethina në gjysmën e dytë të shek. XX-të*. Shkup: Flaka e Vëllazërimit, 1998.
- Vlora, Syrja. *Kujtime. Nga fundi i sundimit osman në Luftën e Vlorës*. Përkthyer nga Ali Asllani, përgatitja për botim dhe redaktimi M. Verli, L. Dushku. QSA, Instituti i Historisë. Tiranë: Iceberg, 2013.

Gazeta e revista:

- Përpyekja Shqiptare*, Tiranë, 1937.
- Lirija*, Selanik, 1908.
- Kombi*, Boston, 1908.
- Korça*, Korçë, 1909.

Webliografia:

<http://sakte.net/manastiri> qyteti i alfabetit pa shkolla shqipe.

NEVILA MEHMETI

“Aleksandër Moisiu” University of Durrës; Faculty of Education
nevilamehmeti@yahoo.com

S u m m a r y

THE NATIONAL MANASTIR MOVEMENT: THE MANASTIR CLUB

This paper focuses on the great contribution made to the National Movement by the Albanian patriots who lived in the city of Manastir, a contribution that culminated in the creation of the Club that bore the city's name. The special feature of this paper is the fact that the source and documentary base refers not only to Albanian archival sources and monographs of Albanian authors, but also to magazines published outside Albanian territory

and monographs of foreign authors, especially Turkish ones. Despite the fact that elaborate research has been done on the contribution of Manastir Club, by comparing the research of local and foreign authors, this paper aims to complete the historical framework of that period. Additionally, this paper presents the different perspectives of the press, Albanian and foreign authors on the effort that the Albanian patriots put in the spreading of education as well as their contribution on the Albanian National Movement.

Immediately after the victory of the Young Turks Revolution, the Albanians set up their own committees in order to better organize the national movement. As a domino effect, from the way these movements spread, Manastir could not be left out. The foundation for this organized national event had already been created years ago. Since 1905, a revolutionary core of the Albanian movement was created in this city, which had openly worked towards getting more national rights.

During the research work for this paper, qualitative methods were used, as well as descriptive and analytical research.